



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM
Nr. 16 Datë 29.10.2020

PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT ZJ. ERMIRA FATMIR BALLIU NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, PËR KËSHILLIN E BASHKISË KAMËZ, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

VËREN

Me shkresën nr. 132 prot., datë 24.09.2020, këshilli i bashkisë Kamëz ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës, për arsye të dorëheqjes nga mandati i këshilltarit zj. Gentjana Gjovalin Lasku.

Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Kamëz, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 46, zj. Ermira Fatmir Balliu.

Me shkresën nr. 1588 prot., datë 14.10.2020 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Kamëz, zj. Ermira Fatmir Balliu, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.



Nr. 16 i vendimit

Data 29.10.2020 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit zj. Ermira Fatmir Balliu nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Kamëz, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0043 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar zj. Ermira Fatmir Balliu, në këshillin e bashkisë Kamëz, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 1720 prot., datë 23.10.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1719 prot., datë 23.10.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Ermira Fatmir Balliu, në Këshillin e Bashkisë Kamëz, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Kamëz, zj. Ermira Fatmir Balliu.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 10831/1 prot., datë 28.10.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Ermira Fatmir Balliu, në këshillin e bashkisë Kamëz, i cili rezulton me status i padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të Kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar zj. Ermira Fatmir Balliu, në këshillin e bashkisë Kamëz, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Kamëz.



PËR KËTO ARSYE:


Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V, i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSA:

1. Zj. Ermira Fatmir Balliu, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Kamëz, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Kamëz, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore zj. Ermira Fatmir Balliu, të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI



Nr. 16 i vendimit

Data 29.10.2020 e vendimit

“Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit zj. Ermira Fatmir Balliu nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë për Këshillin e Bashkisë Kamëz, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.